

ABSTRAKT

Të drejtat e grave për të trashëguar pronë mbeten një nga sfidat kryesore për zhvillimin e shoqërisë së Kosovës, ndërsa rëndësia e saj qëndron në faktin se e njëjta është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila siguron barazi gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, pastaj me Ligji për Trashëgiminë i Kosovës ku trajtohet barazia gjinore dhe e drejta për të trashëguar dhe me Konventa Ndërkombëtare dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Brenda kësaj teme jam munduar që të thellohem më shumë në çështjet që kanë më shumë interes për njerëzit dhe ato të cilat i hasim më shumë në jetën e përditshme.

Çështja e të drejtave trashëgimore të grave në Kosovë është diskutuar e studiuar nga organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare me raporte e rekomandime të shumta të cilat do të mundohem të i përfshijë në këtë punim.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të paraqes një pasqyrim më të detajuar të së drejtave të grave për të trashëguar pronë e në veçanti në evidentimin e problematikave për realizimin e të drejtave të tyre dhe krejt në fund për fuqizimin ekonomik të tyre në Kosovë.

Duke e ditur rëndësinë e këtij punimi jam munduar që sa më mirë dhe sa më thjeshtë ta sqaroj tërë materien në mënyrë që të jetë sa më e kapshme për të gjithë edhe pse ekziston gjithmonë vështirësia duke e ditur se edhe material për këtë temë ka shumë pak.

Fjalët kyçe: Trashëgimia, e drejta e pronës, gratë në trashëgimi, furnizimi ekonomik.